



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 388/5 Prot.

Tiranë më 30.07. 2015

V E N D I M

Nr 82 Datë 30/07 /2015

Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Njësia Bashkiake Nr. 7, Tiranë

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, nenet 80 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe Rregulloren "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin, Njësia Bashkiake Nr. 7, Tiranë,

VËREJ SE:

Në zbatim të vendimit nr. 49, datë 25.05.2015 "*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në institucionin, Njësia Bashkiake Nr. 7 Tiranë*", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur kryesisht, fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në këtë institucion.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjit 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në subjekt filloi në datë 28.05.2015, sipas programit të mbikëqyrjes të miratuar nga Komisioneri nr. 388/1 prot., datë 25.05.2015, njoftuar institucionit me shkresën nr. 388/2 prot., datë 25.05.2015 "*Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes*".

Në përfundim të këtij procesi, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrrur me shkresën 388/3, datë 28.07.2015 "*Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin e administratës vendore, Njësia Bashkiake Nr. 7, Tiranë, në lidhje me administrimin*

e shërbimit civil”, duke i lënë 3 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Në vijim të procesit, Njësia Bashkiake Nr. 7 Tiranë, me shkresën nr. 2883/1 prot., datë 29.07.2015 *“Disa sqarime në lidhje me përmbajtjen e projektraportit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”*, ka kthyer pranë Komisionerit, projektraportin e nënshkruar nga titullari i institucionit dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore bashkë me disa sqarime mbi mënyrën e hartimit dhe miratimit të strukturës organizative të njësive bashkiake të Tiranës, pa paraqitur observacione lidhur me drejtimitet e mbikëqyrjes të trajtuara në pjesët respektive të projektraportit.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Njësia Bashkiake Nr. 7 Tiranë, që është pjesë e këtij vendimi.
2. Nga ana e njësisë së burimeve njerëzore, duhet të mbahen parasysh rekomandimet e Komisionerit, në lidhje me përgatitjen dhe propozimin e strukturës organizative pasardhëse të institucionit, sipas rekomandimeve të bëra në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.
- Në strukturën pasardhëse të institucionit të përcaktohen pozicionet e shërbimit civil duke i veçuar nga pozicionet që kryejnë funksione politike, apo ato që nuk ushtrojnë funksion publik (punonjësit administrativë), duke mbajtur parasysh rekomandimet e dhëna në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.
- Për pozicionet e punës me emërtesën *“Jurist”*, *“Administrator Shoqëror”*, *“Ekonomist”*, *“Arkëtar-Llogaritar”*, njësia përgjegjëse të propozojë njehsimin e tyre me emërtesat e pozicioneve të punës të përcaktuara në nenin 19, pika 7 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 12.03.2014 *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”* si dhe lidhja 3 bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Njësia përgjegjëse të verifikojë plotësimin e kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe të deklarojë statusin e punësimit për punonjësit e punësuar në 2 pozicionet me emërtesën *“Specialist për tregjet”* dhe në pozicionin me emërtesën *“Arkivist-protokoll”*.

Për këto pozicione të shërbimit civil, të hartohen dhe miratohen përshkrimet e punës, në përputhje me legjislacionin specifik të fushës, apo formatin standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”* dhe lidhjes 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike *“Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”*.

Për pozicionet e punës *“Specialist Biblioteke”*, ndaj të cilëve nuk zbatohet ligji për nëpunësin civil, marrëdhënia e punës të rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

4. Institucioni i mbikëqyrur, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme dhe Departamentin e Administratës Publike, të qartësojnë pozicionin e nëpunësve të gjendjes civile, në raport me shërbimin civil.

Pasi të ezaurohet ky bashkëpunim, të vijnë procedurat lidhur me verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe lëshimin e aktit të deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit e Zyrës së Gjendjes Civile: ***** , *“Përgjegjës Zyre”*; ***** , *“Nëpunëse e gjendjes civile”*; ***** , *“Nëpunëse e gjendjes civile”*; ***** , *“Nëpunës i gjendjes civile”*; ***** , *“Nëpunëse e gjendjes civile”*.

Për pozicionet e punës që i përkasin Zyrës së Gjendjes Civile, në zbatim të rekomandimeve të materializuara në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe me Departamentin e Administratës Publike, të hartohen përshkrimet e reja të punës sipas standartit të miratuar.

5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim, duke marrë parasysh se zbatimi i tij kërkon një kohë të kushtëzuar nga afatet procedurale të veprimeve që duhet të kryhen për rregullimin e situatës.

Në këtë rast, zbatimi i këtij vendimi duhet të trajtohet i lidhur ngushtë edhe me veprimet që do të kryhen për implementimin e reformës në administratën vendore.

6. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim, duke u bazuar në rekomandimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
7. Me kalimin e këtij afati, institucioni është i detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi zbatimin e këtij vendimi.

8. Për këtë vendim të njoftohet Njësia Bashkiake Nr. 7, Tiranë, Bashkia e Tiranës, Departamenti i Administratës Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA